



**AKT - THEMELIMI**  
**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ E G L A N D ”**

Sot më datën, 10 Korrik 1999 (Nëntëdhjet e nëntë), une, RASIM DACI, i datëlindjes 20.07.1960, lindur Në Zogaj të Dibrës dhe banues në Tiranë, Bathore - Kamzë, Republika e Shqipërisë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, **v e n d o s a** të krijoj Shoqërinë private “EGLAND” - SH.P.K. në përputhje me legjislacionin në fuqi të në Republikën e Shqipërisë, e veçanërisht me dispozitat e Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, sipas kushteve që

v i j o j n ë :

Neni 1

1.1 Shoqërinë “EGLAND” e krijoj sipas llojit : - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Neni 2

2.1 Shoqëria “EGLAND” do të funksionojë për një periudhë kohe prej njezet vjet, me të drejtë përsëritje edhe në të ardhmen.

Neni 3

Emëritmi dhe qëndra (Selia)

3.1 Emërtimi i Shoqërisë është: - Shoqëria Ndertimore “EGLAND” - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose shkurt: Shoqëria Ndertimore “EGLAND” - Sh.P.K. që në mjaft raste, në dokumente të krijimit të saj do të shkruhet shkurt “Shoqëria”

3.2 Qëndra (selia) e Shoqërisë është: - Bathore – Kamzë, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Tel: \_\_\_\_\_

Fax: \_\_\_\_\_

Neni 4.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “EGLAND” - SH.P.K. është ushtrimi i veprimtarisë së lirë private në fushën:

- Projektim dhe ndërtim i veprave të ndryshme të infrastrukturës, objekte industriale, bujqësore, blegtorale, social - kulturore, tregtare dhe private (banesa vetjake), rrugë, etj.;

- Projektim dhe ndërtim i veprave të ndryshme të bonifikimit, urave, kanalizimeve, etj.;

- Prodhim dhe tregëtim i materialeve të ndryshme të ndërtimit (parafabrikate, pllaka, blloqe etj.), si dhe i atyre inerte (gurë, zhavor, qakull, rene, gëlqere, etj.);

- Import - Eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, blegtorale dhe ushqimore; Makineri dhe aparatura, automjete të ndryshme transporti, bujqësore dhe pjesë këmbimi për to; grumbullim përpunim dhe tregtim të lëndës drusore; artikuj tekstili, shkollore, konfeksione e kancelerie; orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake, aparatura dhe artikuj të ndryshem elektrikë, elektronikë dhe elektroteknike; materiale ndërtimi, instalimi, për ngrohje, hidrosanitare, plastike, kimikate, xham, porcelan dhe qeramikë; agjensi ndërmjetësimi dhe komisionerie; organizim dhe kryerje e shërbimit të transportit tokësor (automobilistik), për mallra dhe pasagjerë, si dhe të serviseve për aparatura dhe automjete të ndryshme, etj. si në territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj.

4.2 Shoqëria krijohet me qëllim që unë, ortaku i vetëm i saj të merren me ushtrimin e veprimtarisë së lirë private dhe të përfitoj prej saj si në territorin e Republikës së shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj, sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, që pasqyrohet në Nenin 4 të këtij Akti.


4.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në aksione, me kuota në shoqëri, filiale e përfaqësi të tjera që kanë të njëjtin objekt ose objekt të ngjashëm me të.

4.4 Shoqëria mund të krijojë filiale, qendra shërbimi e prodhimi, degë, zyra përfaqësimi, agjensi, dyqane, magazina, etj. edhe në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.5 Shoqëria mund të bëjë investime për ndërtimin e objeteve të ndryshme që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së saj ndërtimore, ekonomiko-tregëtare dhe financiare.

## Neni 5

Regjimi Juridik



- 5.1 Në të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 5.2 Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë dhe ortakut të vetëm të saj përcaktohen më hollësisht në Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.
- 5.3 Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.4 Për evidentimin e veprimtarisë së Shoqërisë do të përdoren dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit, siç sqarohet më hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë.
- 5.5 Shoqëria gëzon afirmimin ligjor që nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatën e rrethit të Tiranës.

#### Neni 6

##### Kapitali i Shoqërisë


- 6.1 Kapital bazë i Shoqërisë është:
- a) Në para : - 100.000, i depozituar në Bankën Kombëtare Shqiptare, Dega e Bulqizës.
- 6.2 Kapitali i Shoqërisë do të rritet krahas ecuresë së saj ndertimore, ekonomiko-financiare dhe tregëtare, si dhe të vendimeve që do të marr unë, ortakut i vetëm i saj për ta rritur atë në të ardhmen.
- 6.3 Në rast të vdekjes time, pasuria e Shoqërisë u kalon trashëgimtarëve të mi sipas legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 7

##### Drejtimi i Shoqërisë.

- 7.1 Fillimisht, Shoqëria do të udhëhiqet, administrohet dhe drejtohet nga unë, ortakut i vetëm dhe krijuesi i saj, RASIM DACI, që do të kryej edhe detyrën e administratorit dhe të përfaqësuesit të saj në marrëdhëniet me të tretët.
- 7.2 Krahas ecuresë së veprimtarisë së Shoqërisë, unë, krijuesi i saj, do të mendoj dhe do të vendos edhe për zgjerimin e organeve të ndryshme të drejtimit dhe të administrimit të Shoqërisë.
- 7.3 Për çdo çështje profesionale, si: për çështje juridike, ekonomike, teknike etj. Shoqëria do të angazhojë (emëroj) sipas rastit, juristë, ekonomistë, financiarë, teknikë etj. në mënyrë të vijueshme ose të përkohëshme. duke punësuar specialistë sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 8



### Sigurimi i pasurisë së Shoqërisë

8.1 Pasuria e Shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në institute të tjera shtetërore dhe private ekzistuese dhe ato që mund të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi.

8.2 Masa e pasurisë që do të sigurohet, si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga unë, ortaku i vetëm dhe administratori i Shoqërisë.

#### Neni 9

#### Afati i veprimtarisë së Shoqërisë

9.1 Afati i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë njëzet vjet me të drejtë përsëritje edhe në të ardhmen.

#### Neni 10

#### Likujdimi i Shoqërisë

10.1 Rastet dhe likujdimi i Shoqërisë, si dhe ajo e mbarimit të afatit të Aktit të Themelimit të Shoqërisë, do të jenë ato që pasqyrohen në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 11.

#### Dispozita të përgjithshme

11.1 Ky Akt për themelimin e Shoqërisë ka si pjesë përbërëse të tij edhe Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkëngjitet dhe depozitohet në organet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.

11.2 Në rastet e likujdimit përfundimtar të Shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi, pushon së vepruar edhe ky Akt - Thelemi

11.3 Adresa ligjore e Shoqërisë është: - Bathore – Kamzë, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Tel. \_\_\_\_\_

Fax.: \_\_\_\_\_

11.3 Çdo ndryshim apo shtesë që mund t'i bëhet këtij Akti për themelimin e Shoqërisë, duhet të bëhet me shkrim, të nënshkruhet nga unë, ortaku i vetëm i saj dhe të depozitohet si në dokumentet e Shoqërisë që mbahen në në qendrën (selinë) e saj, ashtu edhe në gjykatën e rrethit të Tiranës.

11.4 Ky Akt - Themelimi i Shoqërisë u pëpilua në pesë kopje të barabarta dhe u nënshkrua në Zyrën e Noterise, Tiranë, ku u depozitua kopja e parë, sot më datën

12. 7. 1999 (Nëntëdhjet e nëntë).

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "ENGLAND"-SH.P.F

*Rashid Isaci*  
*Arif*

S T A T U T I  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" E G L A N D "



Sot, me daten, 10 Korrik 1999 (Nëntëdhjet e nëntë), unë, o r t a k u i vetem, RASIM DACI, i biri i Danit dhe i Azbies, i dt.20.07.1960, lindur ne Zogaj të Dibres dhe banues ne Tirane, Bathore - Kamzë, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, duke u mbeshtetur ne dispoizitat e Ligjit Nr.7512, dt.10.08.1991 "Per sankisionimine e prones private, te nismes se lire..."; te Ligjit Nr.7632, 04.11.1992 "Per dispoizitat qe rregullojne pjesen e Pare te Kodit Tregetar"; te Ligjit Nr.7638, dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" ne Republiken e Shqiperise, si dhe ne mundesite e mia aktuale, v e n d o s a te miratoj kete S t a t u t per krijimin e Shoqerise private "EGLAND" - SH.P.K. me dispoizitat si me poshte:

K R E U I.

Neni 1.

1.1 Shoqerine private " E G L A N D " - SH.P.K. e krijoj sipas llojit: - Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, duke e emertuar: Shoqeria " E G L A N D " - SH.P.K. ose edhe me shkurt: "Shoqeria" siç do te shkruhet ne dispoizitat e ketij Statuti.

Neni 2.

Kohezgjatja.

2.1 Shoqeria " E G L A N D " - SH.P.K.do te funksionoje per nje periudhe kohe prej njezet vjet, me te drejte perseritje edhe ne te ardhmen.

Neni 3

Emertimi dhe qendra (selia).

3.1 Qendra (selia) e Shoqerise eshte: - Bathore – Kamzë, Tiranë, Republika e Shqiperise.

Tel. \_\_\_\_\_

Fax. \_\_\_\_\_

Neni 4.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria me Përgjegjësi të Kufizuar " EGLAND " - SH.P.K. ka për objekt

ushtrimin e veprimtarisë së saj të lirë private në fushën:

- Projektim dhe ndërtim i veprave të ndryshme të infrastrukturës, objekte industriale, bujqësore, blegtorale, social - kulturore, tregtare dhe private (banesa vetjake), rrugë, etj.;

- Projektim dhe ndërtim i veprave të ndryshme të bonifikimit, urave, kanalizimeve, etj.;

- Prodhim dhe tregëtim i materialeve të ndryshme të ndërtimit (parafabrikate, pllaka, blloqe etj.), si dhe i atyre inerte (gurë, zhavor, qakull, rene, gëlqere, etj.);

- Import - Eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, blegtorale dhe ushqimore; Makineri dhe aparatura, automjete të ndryshme transporti, bujqësore dhe pjesë këmbimi për to; grumbullim përpunim dhe tregtim të lëndës drusore; artikuj tekstili, shkollore, konfeksione e kancelerie; orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake, aparatura dhe artikuj të ndryshëm elektrikë, elektronikë dhe elektroteknike; materiale ndërtimi, instalimi, për ngrohje, hidrosanitare, plastike, kimikate, xham, porcelan dhe qeramikë; agjensi ndërmjetësimi dhe komisionerie; organizim dhe kryerje e shërbimit të transportit tokësor (automobilistik), për mallra dhe pasagjerë, si dhe të serviseve për aparatura dhe automjete të ndryshme, etj. si në territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj.

4.2 Shoqeria krijohet me qëllim që, në ortakësi me vetëm një nga të tjerët të ushtrimit të veprimtarisë së lirë private dhe të përfitojë prej saj si në territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj, sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë që pasqyrohet në Nenin 4 të Aktit të Themelimit dhe Nenit 4 të Statutit të Shoqërisë.

4.3 Shoqeria mund të marrë pjesë në aksione, me kuota në shoqëri, filiale e perfaqësi të tjera që kanë të njëjtin objekt ose objekt të ngjashëm me të.

4.4 Shoqeria mund të krijojë filiale, qendra shërbimi e prodhimi, degë, zyra perfaqësimi, agjensi, dyqane edhe në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shoqeria mund të bëjë investime për ndërtimin e objekteve të ndryshme që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së saj

ekonomiko - financiare dhe tregëtare.

### Neni 5

#### Regjimi juridik.

Ne të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe, veçanërisht nga dispozitat e Ligjit Nr. 7638, datë, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare". Për çështje që nuk trajtohet në këtë legjislacion dhe realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohen praktikat tregëtare, si dhe praktikat lokale ose të veçanta, të cilat marrin përparësi ndaj praktikave të përgjithshme. Në mungesë të tyre zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.2 Me vendimin tim, ortakut të vetëm të Shoqërisë, regjimi juridik i saj mund të ndryshojë në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e Shoqërisë sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast, unë ortakut i vetëm dhe Administratori i Shoqërisë, do të përfshijë si Aktin e Themelimit, ashtu edhe Statutin e krijimit të saj, si dhe do të bëjë depozitimet përkatëse si në Gjykatën e rrethit të Tiranës, ashtu edhe në dokumentet që mbahen në qendren (selinë) e saj.

5.3 Shoqëria gëzon mbrojtje dhe siguri të plote në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.4 Shoqëria mund të marrë përsipër detyrime, si dhe mund të padisë dhe të paditet përpara organeve kompetente gjyqësore si në Gjykatën e rrethit të Tiranës, ashtu edhe në gjykata të vendeve të tjera ku do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregëtare.

5.5 Në marrëdhëniet juridike me persona të tjerë, Shoqëria del në emër dhe për llogari të vet.


5.6 **Perfaqësues** i Shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet, jam unë, **administratori** i Shoqërisë: RASIM DACI, ortak i vetëm i saj.

5.7 Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje: "Shoqëria Ndërtimore " EGLAND " - SH.P.K.- SH.P.K. Eksport - Import, Tirana, ALBANIA".

### K R E U II.

### Neni 6

#### Kapitali i Shoqërisë



6.1 Kapitali baze (themeltar) i Shoqerise eshte:

a) Në para: - 100.000 (njeqind mije) leke, i depozituar ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

6.2 Kapitali i Shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomiko - financiare dhe tregtare, si dhe te vendimeve qe do te marr, unë, ortaku i vetem i saj, per ta rritur ne te ardhmen.

6.3 Në rast te vdekjes time, pasuria e Shoqerise u kalon trashegimtareve te mi ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### Neni 7

#### Të drejtat dhe detyrat e Shoqerise.

7.1 Shoqeria ka te drejte te lidhe kontrata e marreveshje si ne territorin e Republikes se Shqiperise, ashtu edhe jasht saj.

7.2 Shoqeria gezon te drejten qe te krijojë në vijimesi pasuri (vlera) materiale dhe intelektuale (mendore).

7.3 Shoqeria gezon te drejten te beje importime dhe eksportime sipas nevojave qe i paraqiten per realizimin e qellimit te saj, duke mos patur asnje pengese. Gjithashtu, Shoqeria ka te drejten e importimit pa asnje obligim e tatim te mjeteve materiale per materializimin e qellimeve investuese.

7.4 Unë, ortaku i vetem dhe administratori i Shoqerise gezoj te drejten e caktimit te çmimeve te artikujve dhe sherbimeve qe disponoj per tregun e brendshem dhe te jashtem, sipas dispozitave ligjore dhe rregullave ne fuqi te vendeve ku realizohen.

7.5 Shoqeria gezon te drejten e krijimit te filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit, qendrave te grumbullimit apo te perpunimit te produkteve te ndryshme, te sherbimeve, dyqaneve, magazinave etj. si ne territorin e Republikes se Shqiperise, ashtu edhe jashte saj.

7.6 Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri te perbashketa ekzistuese dhe ato qe mund te krijohen ne te ardhmen si ne territorin e Republikes se Shqiperise, ashtu edhe jashte saj, në perputhje me legjislacionin ne fuqi në territorin perkates ku do te ushtrohet veprimtaria e perbashket.



7.7 Shoqeria ka te drejten e administrimit ekskluziv te pasurise se saj, ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Ajo ka te drejten e venies ne hipoteke te elementeve te saj pasurore, ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti.

7.8 Unë, ortaku i vetem i Shoqerise, mbaj pergjegjesi deri ne nivelin e kontributit në kapitalin baze (themeltar).

7.9 Filialet, deget, perfaqesite, agjensite etj. qe mund te krijohen nga ana e Shoqerise pergjigjen per detyrimet e tyre, por edhe Shoqeria ka pergjegjesine e vet per to.

### K R E U III.

#### Drejtimi dhe udheheqja e Shoqerise.

8.1 Fillimisht, Shoqeria do te drejtohet, administrohet dhe udhehiqet nga unë, administratori dhe ortaku i vetem i saj, qe do te jem edhe perfaqesues i Shoqerise ne marredheniet me te tretet.

8.2 Krahas ecurise se veprimtarise se Shoqerise, unë, ortaku i vetem dhe krijuesi i saj, do te mendoj dhe do te vendos edhe per zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit te Shoqerise.

8.3 Kompetencat kryesore te ortakut te vetem:

- bej ndryshime ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te Shoqerise;
- bej ndryshime ne objektin e veprimtarise se Shoqerise;
- miratoj rezultatet vjetore te Shoqerise;
- vendos per krijimin ose mbylljen e filialeve, degeve, perfaqesive, agjensive

simotra etj. brenda dhe jashte vendit;

- riorganizoj ose mbyll Shoqerine;
- miratoj projekte per zgjerimin dhe materializimin e veprimtarise se Shoqerise;
- miratoj raportin vjetor te veprimtarise se kryer nga administrata e Shoqerise;
- vendos per çmimet dhe tregjet e shitjes te artikujve te ndryshem brenda dhe

jashte vendit;

- emëroj dhe shkarkoj nga detyra personelin e Shoqerise, i zëvendesoj ata dhe u percaktoj shperblimin qe do t`u jepet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



## K R E U IV.

## Neni 9.

## Dispozita ekonomike.

9.1 Veprimtaria ekonomiko - financiare dhe tregtare e Shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

9.2 Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregetar dhe juridike me persona te trete, Shoqeria pergjigjet me pasurine e vet.

9.3 Aktivi dhe pasivi i veprimtarise se Shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomiko - financiare dhe tregtare te saj, te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj.

9.4 Pasurite e Shoqerise vleresohen nepermjet bilanceve ekonomiko - financiare dhe tregtare te saj, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

9.5 Të ardhurat e Shoqerise, pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se palujtshme dhe te lujtshme, si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interes te Shoqerise, me takojne mua, ortakut te vetem te saj sipas dispozitave te percaktuara ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e krijimit te saj, apo te vendimeve qe mund te marr unë, ne te miren e zhvillimit dhe te zgjerimit te veprimtarise se Shoqerise.

9.6 Për detyrimet, Shoqeria pergjigjet me fondet e veta.

9.7 Shoqeria eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se vetë. Në perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise së saj, Shoqeria mund te bleje dhe te shfrytetoje edhe aksione te personave te trete.

9.8 Objektet dhe mjetet perdorimit Shoqeria i siguron prane Institutit te Sigurimeve te Republikes se Shqiperise, si dhe ne institute te tjera shteterore dhe private ekzistuese dhe ato qe mund te krijohen ne te ardhjen sipas legjislacionit ne fuqi.

9.9 Masa e pasurise qe do te sigurohet, si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga une, ortaku i vetem dhe administratori i saj.

## Neni 10

## Llogaria e Shoqerise.

10.1 Shoqeria, llogarine rrjedhese te saj e ka ne Banken Kombetare Shqiptare, Dega e Tiranes. Ajo mund te çelë edhe llogari te tjera rrjedhese, siç do ta shoh te aresyeshme unë, ortaku i vetem i saj.

10.2 Shoqeria i mban llogarite ne leke shqiptare ose ne valute te huaj sipas rastit qe i paraqitet per veprime në vlera te ndryshme monetare.

10.3 Të gjitha shpenzimet e Shoqerise ne leke apo ne valute te huaj, sigurohen nga arketimet e shërbimeve dhe veprimeve qe pasqyrohen ne objektin e veprimtarise se saj ose nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 11.

Viti ekonomik.

11. Viti ekonomik fillon me 1 Janar te çdo viti kalendarik, kurse per vitin 1999, qysh nga fillimi i veprimtarise se Shoqerise dhe perfundon me 31 Dhjetor 1999.

Neni 12.

Dhenia e llogarise ekonomike.

12.1 Shoqeria funksionon ne baze te dispozitave ligjore ekonomike ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, te dispozitave te Aktit te Themelimit dhe te Statutit te krijimit te saj, si dhe te programeve te veçanta qe do te hartoj une, ortaku i vetem i saj per çdo vit ekonomik.

12.2 Lloagria ekonomike e Shoqerise mbeshtetet ne llogarite e tregetimeve, shërbimeve dhe te vetefinancimeve qe mbulon shpenzimet e veta, duke perfshire edhe ato ne valute.

12.3 Per nxitjen ekonomike te veprimtarise se Shoqerise do te krijohen fonde rezerve dhe fonte te tjera te veçanta ne perputhje me mundesite ekonomiko - financiare dhe tregtare te saj.

12.4 Mbajtja e kontabilitetit te Shoqerise do te behet sipas rregullave, metodave dhe teknikave kontabel, veprimeve qe ajo kryen, si dhe te ngjarjeve qe i ndodhin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomiko - financiare dhe tregtare.

12.5 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen shqipe dhe ne leke shqiptare sipas ligjeve dhe rregullave ne fuqi, si dhe ne valute te huaj per çka do ta shoh te aresyeshme unë, ortaku i vetem i Shoqerise.

12.6 Per mbajtjen e kontabilitetit do te perdoret "Libri ditar", "Libri i Madh", "Libri inventar" dhe çdo liber tjetër i detyrueshem qe parashikohet nga Kodi Tregetar dhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi, te cilat mbahen dhe administrohen nga unë, administratori i saj dhe punonjesit e tjere qe do te punesoj ne administrate.

12.7 Per veç librave te detyrueshem, në qofte se do ta shikoj te aresyeshme unë, administratori i saj, Shoqeria do te perdore edhe libra te tjere per regjistrimin e veprimeve, ngjarjeve dhe gjendjeve qe paraqiten dhe nevojiten.

12.8 Forma e organizimit te kontabilitetit do te zgjidhet nga une, administratori i Shoqerise, duke patur parasysh qe ajo te siguroje:

- regjistrim te hollesishem dhe kronologjik te te gjitha veprimeve dhe ngjarjeve qe trajtohen ne kontabilitet;

- ruajtjen e te dhenave dhe disponimin e tyre ne çdo kohe;

- pergatitjen e dokumenteve permbledhese te parashikuara ose te kerkuara, si dhe,

- kontrollin e saktetise se te dhenave te trajtuara.

12.9 Çdo forme organizimi te kontabilitetit qe do te perdoret, do te jete e tille qe te mundesoje kryerjen e kontrollit te jashtem ne menyre te tille qe, çdo ekspert te nxjerre nga librat kontabel, brenda nje kohe te aresyeshme, nje pamje te pergjithshme te veprimeve te kryera dhe te veprimtarise se Shoqerise.

12.10 Kontrolli i pergjithshem dhe statistikor behet mbi bazen e dispozitave ligjore qe veprojne ne Republiken e Shqiperise dhe ato qe do te percaktoj vete une, administratori i saj.

12.11 Kontrolli i librave kontabel behet çdo vit nga ekspertet kontabel, te cilet emerohen nga une, administratori i Shoqerise, ne perputhje me Nenin 65 te Ligjit Nr.7638, date, 19.11.1992 per "Shoqerite Tregetare" .

Neni 13.

Raporti vjetor.

13.1 Raporti vjetor i llogarise se Shoqerise do te paraqitet ne formen dhe permbajtjen e percaktuar ne Nenin 211 te Ligjit Nr.7638, dt. 19.11.1992 per "Shoqerite Tregetare".

Neni 14.

Kredite e Shoqerise.

14.1 Shoqeria ka te drejte marre kredi ne leke dhe ne valute te huaj si ne Banken Kombetare Shqiptare, ashtu edhe ne banka te tjera qe ndodhen ne Republiken e Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, te rregullave te percaktuara nga bankat, si dhe te dispozitave te ketij Statuti.

## K R E U V.

### Neni 15.

Rastet e nderprerjes se veprimtarise se Shoqerise.

Unë, ortaku i vetem dhe administratori i Shoqerise kam te drejten e nderprerjes se marredhenieve qe rrjedhin nga Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqerise, kur per kete vertetohen aresye serioze, siç mund te jenë:

- Veprimi i kushteve te forcave madhore qe parashikohe ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise;

- Myllja (likuidimi) e Shoqerise behet ne rastet qe permenden ne kete nen, si dhe ne rastet qe vijojne:

- Varferimi i Shoqerise;

- Dalja e nje vendimi nga organet kompetente qe e ndalon veprimtarine e Shoqerise, ne qofte se nje funksionim i tille vjen ne kundershtrim me ligjin edhe gjate kohes qe vepron vendimi.

- Marrja e vendimit perkates nga une, ortaku i i saj.

### Neni 16.

#### Proçedura e likuidimit

16.1 Pas nderprerjes se funksionimit te saj, Shoqeria likuidohet. Per kete, une, ortaku i vetem i saj caktoj, sipas rastiit dhe nevojës: likuidatorin ose Komisionin e Likuidimit. Nga çasti i caktimit te likuidatorit ose te Komisionit te Likuidimit te gjitha kompetencat e Shoqerise i kalojne Likuidatorit ose ketij komisioni sipas dispozitave ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

16.2 Komisioni i Likuidimit perbehet nga tre anetare, prej te cileve njeri caktohet ne rolin e kryetarit (pergjegjesit)



16.3 Anetaret e komisionit te Likujdimit veprimtarine e tyre e kryejne vetem bashkerisht dhe ne asnje menyre vecmas. Shpenzimet per te gjitha detyrimet e Shoqerise, i perballon vete Shoqeria.

## K R E U VI.

Dispozita te pergjithshme.

### Neni 17.

Ndryshime te favorshme ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

17.1 Ne qofte se ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje, dekrete ose vendoset nje politike me e favorshme nga legjislacioni i pasqyruar ne Aktin dhe Statutin e krijimit te Shoqerise, atehere unë, ortaku i vetem dhe administratori i saj, kam te drejten (ne qofte se eshte e domosdoshme) t' u drejtohem organeve perkatese shteterore dhe administrative qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem per mua dhe per Shoqerine e krijuar nga unë.

### Neni 18.

Zgjidhja e mosmarreveshjeve.

18.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis personave te ndryshem dhe Shoqerise do te zgjidhen kryesisht mbi bazen e bisedimeve dashamirese e me mirekuptim me njeri - tjetrin. Ne qofte se kjo nuk mund te arrihet, atehere pala e interesuar mund t'i drejtohet organeve kompetente te juridiksonit te vendit (krahines) ku kane lindur mosmarrveshjet, si dhe organeve te tjera ligjore me kompetenca me te larta per mbrojtjen me ligj te te drejtave te veta.

### Neni 19.

Dispozita te vecanta.

19.1 Te gjitha dokumentet e Shoqerise (kontratat, akt - marreveshjet, faturat, etj.), do te permbajne adresen e plote te saj, numrin e regjistrimit ne regjistrin tregëtar te Gjykates te rrethit te Tiranes, si gjykata regjistruese e Shoqerise, si dhe numrin e regjistrimit te organit tatimor te njesise administrative ku do ta ushtroje veprimtarine e saj.

19.2 Per çeshtje te tilla qe nuk parashikohen ne kete Statut, veprimtaria e Shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 20.

Hyrja ne fuqi.

20.1 Ky Statut, i perpiluar nga unë, ortaku i vetem i Shoqerise ne pese kopje te barabarta, hyn ne fuqi qysh ne momentin ne nenshkrimet te tij nga ana ime ne Zyren e Noterise, Tirane, ku do te depozitohet kopja e pare.

20.1 Në rastet e likuidimit perfundimtar te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi, pushon se vepruari edhe ky Statut i saj.

20.3 Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit tregetar, si dhe te ecurise se veprimtarise se Shoqerise, une, ortaku i vetem i saj, kam te drejten e permiresimit te metejshem edhe te dispozitave te ketij Statuti dhe te te gjitha dokumenteve te Shoqerise, duke bere depozitimet perkatese sipas legjislacionit ne fuqi.

20.4 Statuti i mesiperm u nenshkrua sot, me daten, \_\_.07.1999 (Nëntëdhjet e nëntë).

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE ME PERGJEGJESI

TE KUFIZUAR " EGLAND "

/RASIM DACI/

Rasim Daci

